



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-44

PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË KONCESIONEVE

Kuvendi i Kosovës,

Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut, Nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, Kreun 5.1 (b), (ç) dhe (i), 5.7 dhe 9.1.26 (a);

Me qëllim të zhvillimit të mëtutjeshëm të parimeve të përgjithshme të transparencës, ekonomisë dhe të drejtësisë gjatë dhënies së kontratave nga autoritetet publike përmes krijimit të procedurave të veçanta për dhënien e kontratave të koncesionit;

Duke patur parasysh nevojën për harmonizimin e procedurave që përfundojnë në dhënien e koncesioneve në pajtim me standardet dhe praktikat e pranura ndërkombëtare;

Miraton:

LIGJIN PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË KONCESIONEVE

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizimet

Në kuadër të këtij ligji:

“**Kontratë Koncesioni**” nënkupton një kontratë të lidhur mes një Autoriteti Kontraktues dhe një koncesionari ku objekti kryesor i kontratës është zbatimi i një projekti të infrastrukturës dhe ku përmbushja e kontratës nga koncesionari shpërblehet tërësisht ose pjesërisht me dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të infrastrukturës.

“**Infrastrukturë**” nënkupton çdo objekt fizik dhe sistem që drejtpërdrejtë ose tërthorazi ofron shërbime ose gjëra me vlerë në interes të publikut të përgjithshëm.

“**Projekt Infrastruktura**” (në tekstin vijues “Projekt”) nënkupton dizajnimin, ndërtimin, zhvillimin dhe veprimin e një infrastrukture të re ose rehabilitimin, modernizimin, zgjerimin ose veprimin e një infrastrukture ekzistuese.

“**Autoritet Kontraktues**” nënkupton autoritetin publik të cilit në bazë të ligjit në fuqi në Kosovë i është dhënë e drejta të jep një koncesion.

“**Koncesionar**” është personi i cili kryen një Projekt në bazë të një kontrate koncesioni të lidhur me një Autoritet Kontraktues.

“**Shoqëri tregtare**” ka kuptimin e paraparë në Rregulloren Nr. 2001/6 të datës 8 shkurt 2001 mbi shoqëritë tregtare, përfshirë aty edhe çdo lloj legjislacioni vijues.

“**Ofertues**” nënkupton persona ose ndërmarrje, përfshirë aty edhe grupe të tyre, që marrin pjesë në procedura seleksionimi lidhur me një Projekt.

“**Propozim jo i kërkuar**” nënkupton çdo propozim lidhur me zbatimin e një Projekti i cili nuk është paraqitur si përgjigje ndaj një kërkesë ose shpallje të një Autoriteti Kontraktues në kuadër të një procedure seleksionimi.

“**Autoritet Publik**” përfshinë (i) çdo organ publik qendror, regjional, komunal, lokal, ministri, departament, agjencion ose organ tjetër publik që në bazë të një ligji ose të një akti nënligjor ushtron kompetenca ekzekutive, legjislative, rregullative, administrative ose gjyqësore; (ii) çdo organ të së drejtës publike; dhe (iii) një asociacion të një ose më shumë organeve të tilla.

“**Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik**” është Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik i themeluar sipas Pjesës së V-të të Ligjit për Prokurimin Publik.

Neni 2 Fushëveprimi

2.1. Procedurat për dhënien e kontratës së koncesionit, përmbajtja e kontratës së koncesionit si dhe çështjet e ndërlidhura rregullohen me këtë ligj. Për çështjet që nuk përfshihen nga ky ligj zbatohen dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik mbi Kontratën Punë me Koncesion.

2.2. Në rast të një kundërthënie mes këtij ligji dhe dispozitave përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik, dispozitat e këtij ligji kanë epërsi.

Neni 3 Pavlefshmëria e kontratës së koncesionit

Një kontratë koncesioni, e cila është dhënë nga një Autoritet Kontraktues në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, është e pavlefshme.

II. SELEKSIONIMI I KONCESIONARIT

Neni 4 Rregullat që zbatohen gjatë procedurës së seleksionimit

Seleksionimi i koncesionarit bëhet (i) në pajtim me nenet 5 deri 27 të këtij ligji, dhe (ii) për çështjet që nuk janë të rregulluara me këto dispozita, në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik.

1. Para-seleksionimi i ofertuesve

Neni 5

Qëllimi dhe procedura e para-seleksionimit

- 5.1. Autoriteti Kontraktues zhvillon procedurën e para-seleksionimit me qëllim të identifikimit të ofertuesve të kualifikuar për zbatimin e projektit të paraparë.
- 5.2. Ftesa për pjesëmarrje në procedurën e para-seleksionimit publikohet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit për prokurim publik.
- 5.3. Ftesa për pjesëmarrje në procedurën e para-seleksionimit përmban së paku këto të dhëna:
- Përshkrimin e infrastrukturës;
 - Një indikacion të elementeve tjera thelbësore të projektit, si p.sh. shërbimet që duhen të kryhen nga Koncesionari ose aranzhmanet financiare të parapara nga Autoriteti Kontraktues;
 - Një përmbledhje të kushteve kryesore të Kontratës së Koncesionit që do të lidhet, nëse këto kushte janë të njohura në këtë fazë;
 - Mënyra dhe vendi i dorëzimit të kërkesave për para-seleksionim dhe afati i dorëzimit si datë dhe kohë e specifikuar që i jep ofertuesit kohë të mjaftueshme për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës; dhe
 - Mënyrën dhe kohën e marrjes së dokumentacionit të para-seleksionimit.
- 5.4. Dokumentacioni i para-seleksionimit përmban së paku këto të dhëna:
- Kriteret e para-seleksionimit sipas nenit 6;
 - Nëse Autoriteti Kontraktues parasheh përjashtimin e kufizimit lidhur me pjesëmarrjen e konsorciumeve sipas nenit 7;
 - Nëse Autoriteti Kontraktues parasheh që vetëm një numër i kufizuar i ofertuesve të para-selektuar të dorëzojë propozime pas përfundimit të procedurës së para-seleksionimit sipas nenit 8, paragrafi 2, dhe, nëse parashihet një gjë e tillë, mënyrën se si do të bëhet ky seleksionim;
 - Nëse një Autoritet Kontraktues parasheh që ofertuesi i suksesshëm të themelojë një formë të veçantë të një organizate afariste sipas nenit 30.

Neni 6

Kriteret e para-seleksionimit

Për t'u kualifikuar për procedurë seleksionimi, ofertuesit e interesuar duhet të plotësojnë kritere objektivisht të arsyeshme të cilat Autoriteti Kontraktues i konsideron si të përshtatshme për procedurën përkatëse siç janë të cekura në dokumentacionin e para-seleksionimit. Këto kritere përmbajnë së paku këto elemente:

- Kualifikime adekuate profesionale dhe teknike, fuqi punëtore, pajisje dhe mjete tjera fizike që janë të nevojshme për zbatimin e projektit, përfshirë dizajnimin, ndërtimin, veprimin dhe mirëmbajtjen;

- b Aftësi të mjaftueshme për të drejtuar aspektet financiare të projektit dhe aftësi për të përmbushur nevojat e financimit;
- c Aftësi të nevojshme drejtuese dhe organizative, besueshmëri dhe përvojë, përfshirë aty edhe përvojën në veprimin e infrastrukturave të ngjashme.

Neni 7

Pjesëmarrja e konsorciumeve

7.1. Me rastin e ftesës së parë për pjesëmarrje të ofertuesve në procedurë seleksionimi, Autoriteti Kontraktues lejon që ofertuesit të krijojnë konsorciume ofertimi. Të dhënat që kërkohen nga anëtarët e konsorciumeve për të treguar kualifikimet e tyre sipas nenit 6 kanë të bëjnë me konsorciumin si të tillë si dhe me anëtarët individual

7.2. Përveç nëse nuk është paraparë ndryshe në dokumentacionin e para-seleksionimit, çdo anëtar i një konsorciumi mund të marrë pjesë drejtpërdrejtë ose tërthorazi në vetëm një konsorcium në të njëjtën kohë. Veprimet në kundërshtim me këtë rregull rezultojnë në përjashtimin e konsorciumit dhe të anëtarit përkatës.

7.3. Kur të merren parasysh kualifikimet e konsorciumeve, Autoriteti Kontraktues merr në konsideratë kualifikimet e secilit anëtar të konsorciumit dhe vlerëson nëse kualifikimet e kombinuara të anëtarëve të konsorciumit janë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e të gjitha fazave të projektit.

Neni 8

Vendimi mbi para-seleksionimin

8.1. Autoriteti Kontraktues merr vendim lidhur me kualifikimet e secilit ofertues i cili ka dorëzuar kërkesë për para-seleksionim. Gjatë marrjes së këtij vendimi, Autoriteti Kontraktues merr parasysh vetëm ato kritere që janë paraparë në dokumentacionin e para-seleksionimit. Të gjithë ofertuesit e para-seleksionuar ftohen pastaj nga Autoriteti Kontraktues që të dorëzojnë propozimet e tyre në pajtim me nenet 9 deri 17.

8.2. Pavarësisht prej paragrafit 1, dhe nëse këtë e ka paraparë në dokumentacionin e para-seleksionimit, Autoriteti Kontraktues mund ta rezervojë të drejtën që pas përfundimit të procedurës së para-seleksionimit të kërkojë propozime vetëm nga një numër i kufizuar i ofertuesve të cilët më së miri i përmbushin kriteret e para-seleksionimit. Për këtë qëllim Autoriteti Kontraktues radhitë sipas rangut ofertuesit të cilët i plotësojnë kriteret e para-seleksionimit në bazë të kriterëve që janë marrë parasysh për të vlerësuar kualifikimet e tyre dhe përgatit listën e ofertuesve që do të ftohen për të dorëzuar propozimet e tyre pas përfundimit të procedurës së para-seleksionimit. Gjatë përgatitjes së listës Autoriteti Kontraktues përcakton rangun vetëm sipas mënyrës së paraparë në dokumentacionin e para-seleksionimit.

2. Procedurat për kërkimin e propozimeve

Neni 9

Procedurat një-shkallëshe dhe dy-shkallëshe për kërkimin e propozimeve

9.1. Autoriteti Kontraktues i jep çdo ofertuesi të para-seleksionuar një pako të kërkesës për propozim dhe të dokumentacionit tjetër përkatës të lëshuar në pajtim me nenin 10, pasi që ofertuesi i para-seleksionuar të ketë kryer pagesën për dhënien e këtij dokumentacioni, nëse kërkohet një pagesë e tillë.

9.2. Pavarësisht prej dispozitave të paragrafit 1 më lart, Autoriteti Kontraktues mund të zbatojë procedurën dy-shkallëshe për të kërkuar propozime nga ofertues të para-seleksionuar, nëse Autoriteti Kontraktues nuk e konsideron të nevojshme të përshkruaj në kërkesën për propozim karakteristikat e projektit - siç janë specifikacionet e projektit, indikatorët për vlerësimin e kryerjes së punës, aranzhmanet financiare ose kushtet e kontratës - në mënyrë ashtu të hollësishme që të mundësohet përgatitja e propozimeve përfundimtare.

9.3. Me rastin e zbatimit të procedurës dy- shkallëshe zbatohen dispozitat në vijim:

- a. Kërkesa fillestare për propozime fton ofertuesit të dorëzojnë - në fazën e parë të procedurës - propozime fillestare lidhur me specifikacionet e projektit, indikatorët për vlerësimin e kryerjes së punës, aranzhmanet financiare dhe karakteristika tjera të projektit si dhe lidhur me kushtet kryesore të kontratës të propozuar nga Autoriteti Kontraktues;
- b. Autoriteti Kontraktues fton në mbledhje dhe mbanë diskutime me secilin ofertues të interesuar për të shqyrtuar pyetjet që ka ofertuesi lidhur me kërkesën fillestare për propozime. Po ashtu, Autoriteti Kontraktues mund të fton dhe të mbajë diskutime me secilin ofertues lidhur me propozimet fillestare dhe dokumentet përcjellëse të dorëzuara nga ofertuesi. Autoriteti Kontraktues përgatit procesverbalin e çdo mbledhjeje ose diskutimi të tillë, i cili përmban pyetjet e shtruar dhe qartësimet e dhëna nga Autoriteti Kontraktues;
- c. Pas shqyrtimit të propozimeve të pranuar, Autoriteti Kontraktues mund të rishqyrtojë dhe, sipas nevojës, të riformulojë kërkesën fillestare për propozime duke shlyer, modifikuar ose shtuar ndonjë element të specifikacioneve fillestare të projektit, të indikatorëve për vlerësimin e kryerjes së punës, të nevojave financiare ose të karakteristikave tjera të projektit, përfshirë aty edhe kushtet kryesore të kontratës, si dhe çdo kriter për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve dhe për identifikimin e ofertuesit të suksesshëm, siç është paraparë në kërkesën fillestare për propozim. Autoriteti Kontraktues e dokumenton në mënyrën e paraparë në nenin 26 arsyen e çdo ndryshimi të kërkesës për propozime. Çdo shlyerje, modifikim ose shtesë komunikohet në ftesën për dorëzimin e propozimeve përfundimtare;
- d. Në fazën e dytë të procedurës, Autoriteti Kontraktues fton ofertuesit të dorëzojnë propozime përfundimtare përkitazi me një pako të vetme të specifikimeve të projektit, indikatorëve për vlerësimin e kryerjes së punës ose kushteve të kontratës në pajtim me nenet 10 deri 17.

Neni 10

Përmbajtja e kërkesës për propozime

Kërkesa për propozime përmban së paku këto të dhëna:

- a. Informata të përgjithshme që mund të kërkohej nga ofertuesit kështu që ata të mund të përgatisin dhe të dorëzojnë propozimet e tyre, përfshirë aty edhe afatin për dorëzim;
- b. Specifikacionet e projektit dhe indikatorët për vlerësimin e kryerjes së punës, përfshirë aty edhe kërkesat e Autoritetit Kontraktues që i përkasin standardeve të sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit;

- c. Kushtet e kontratës të propozuara nga Autoriteti Kontraktues, duke theksuar se cilat kushte konsiderohen si jo të negociushme;
- d. Kriteret për vlerësimin e propozimeve dhe kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues, nëse ka të tilla, për të identifikuar propozime të pamjaftueshme; peshën përkatëse që i jepet çdo kriteri të vlerësimit; dhe mënyra në bazë të së cilës këto kritere zbatohen gjatë vlerësimit dhe refuzimit të propozimeve.

Neni 11 Mjetet siguruese

11.1. Kërkesa për propozime përcakton kushtet lidhur me natyrën, formën, vlerën dhe kushtet tjera që kanë të bëjnë me mjetin e sigurimit i cili kërkohet për të siguruar ofertën, si dhe kushtet lidhur me personin që e jep një mjet të tillë sigures.

11.2. Nuk mund të ekzekutohet në një mjet sigures përveç në rast:

- a. të tërheqjes ose modifikimit të një propozimi pas skadimit të afatit për dorëzimin e propozimeve dhe, nëse është paraparë një gjë e tillë në kërkesën për propozime, para skadimit të këtij afati;
- b. të mos hyrjes në negociata përfundimtare me Autoritetin Kontraktues sipas nenit 17, paragrafit 1;
- c. të mosdorëzimit të ofertës më të mirë dhe përfundimtare brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues në pajtim me nenin 17, paragrafin 2;
- d. të mos nënshkrimit të kontratës së koncesionit , nëse kjo kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, pasi që propozimi të jetë pranuar;
- e. të mos ofrimit të mjeteve siguruese të kërkuara për përmbushjen e Kontratës së Koncesionit pasi që propozimi të jetë pranuar ose të mos përmbushjes së ndonjë kushti tjetër para nënshkrimit të kontratës së koncesionit të përcaktuar në kërkesën për propozime.

Neni 12 Qartësime dhe modifikime

Me vetiniciativë ose në bazë të kërkesës të një ofertuesi, Autoriteti Kontraktues mund të rishqyrtojë dhe, sipas nevojës, të riformulojë secilin element të kërkesës për propozime sipas nenit 10. Autoriteti Kontraktues e dokumenton në mënyrën e paraparë në nenin 26 arsyen e çdo ndryshimi të kërkesës për propozime. Çdo shlyerje, modifikim ose shtesë i komunikohet ofertuesve në mënyrën e njëjtë si kërkesa për propozime në kohë të duhur para skadimit të afatit për dorëzimin e propozimeve.

Neni 13

Ofertuesit dorëzojnë propozimet e tyre në formë shkresore, të nënshkruar dhe të mbyllur në zarf. Propozimet që merr Autoriteti Kontraktues pas skadimit të afatit për dorëzimin e propozimeve nuk hapen dhe i kthehen ofertuesit që i ka dërguar.

Neni 14 Kriteret e vlerësimit

14.1. Kriteret për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve teknike përmbajnë së paku këto elemente:

- a Korrektësia teknike;
- b Pajtueshmëria me standarde për mbrojtjen e mjedisit;
- c Zbatueshmëria operationale;
- d Cilësia e shërbimeve dhe masave që merren për të siguruar vazhdimin e tyre.

14.2. Kriteret për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve financiare dhe komerciale përmbajnë, sipas rrethanave të rastit konkret, këto elemente:

- a. Vlerën aktuale të taksave, njërive të çmimeve dhe pagesave tjera gjatë periudhës së koncesionit;
- b. Vlerën aktuale të pagesave të drejtpërdrejta të propozuara nga Autoriteti Kontraktues, nëse ka të tilla;
- c. Shpenzimet e dizajnit dhe të ndërtimit, të veprimit dhe të mirëmbajtjes gjatë vitit, vlerën aktuale të shpenzimeve kapitale si dhe të veprimit dhe të mirëmbajtjeve;
- d. Vëllimi i ndihmës financiare nga ndonjë autoritet publik, nëse ka nevojë për një gjë të tillë;
- e. Korrektësia e aranzhmaneve financiare të propozuara;
- f. Shkalla e pranueshmërisë së kushteve të negociushme të kontratës së propozuar nga Autoriteti Kontraktues në kërkesën për propozime;
- g. Potenciali për zhvillim ekonomik dhe shoqëror i ofruar nga propozimet.

Neni 15 Krahasimi dhe vlerësimi i propozimeve

Autoriteti Kontraktues krahason dhe vlerëson çdo propozim në pajtim me kriteret e vlerësimit, peshën përkatëse që i jepet secilit kriter dhe procesin e vlerësimit të paraparë në kërkesën për propozime.

Neni 16 Përmbushja e kriterëve të kualifikimit

Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga secili ofertues i cili është para-seleksionuar që të dëshmojë sërish kualifikimet e tij në pajtim me të njëjtat kriterë që janë përdorur gjatë para-seleksionimit. Autoriteti Kontraktues mund ta diskualifikojë çdo ofertues që nuk dëshmon sërish kualifikimet e tij nëse kjo kërkohet nga ai.

Neni 17 Negociata përfundimtare

17.1. Autoriteti Kontraktues radhit sipas rangut të gjitha propozimet e mjaftueshme në bazë të kriterëve të vlerësimit dhe e fton në negociata përfundimtare për lidhjen e kontratës së koncesionit ofertuesin që ka rangun më të lartë. Negociatat përfundimtare

nuk kanë për objekt kushtet e kontratës të cilat janë caktuar si të pa negociueshme në kërkesën përfundimtare për propozime.

17.2. Nëse bëhet e qartë për Autoritetin Kontraktues që negociatat me ofertuesin e ftuar nuk do të rezultojnë në lidhjen e kontratës së koncesionit, atëherë Autoriteti Kontraktues e njofton ofertuesin se ka ndërmend të ndërprejë negociatat dhe i jep ofertuesit kohë të mjaftueshme që të formulojë më mirë ofertën e tij përfundimtare. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk e konsideron këtë propozim si të pranueshëm, atëherë i ndërprejnë negociatat me ofertuesin përkatës. Në vijim, Autoriteti Kontraktues fton për negociata ofertuesit tjerë sipas rangut që kanë deri sa të arrihet lidhja e kontratës së koncesionit ose të refuzohen të gjitha propozimet e mbetura. Autoriteti Kontraktues nuk mund të rifillojë negociata me një ofertues me të cilin janë ndërprerë negociatat sipas këtij paragrafi.

3. Negociatat për kontratë koncesioni pa procedurë konkurruese

Neni 18

Rrethana të cilat lejojnë dhënien e koncesionit pa procedurë konkurruese

Me pëlqim të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik, Autoriteti Kontraktues mund të negociojë një kontratë koncesioni pa zbatuar procedurat e parapara në nenet 5 deri 17 në këto raste:

- a. kur ka një nevojë urgjente për të siguruar vazhdimësinë e një shërbimi dhe nëse zbatimi i procedurave të parapara në nenet 5 deri 17 nuk do të ishte praktik, por me kusht që rrethanat që kanë për pasojë urgjencën as nuk kanë qenë të parashikueshme nga Autoriteti Kontraktues dhe as nuk janë pasojë e një zvarritjeje të Autoritetit Kontraktues;
- b. kur projekti ka një kohëzgjatje të shkurtë dhe vlera e investimit të pritur fillestar nuk tejkalon 10.000 €;
- c. kur projekti ka të bëjë me çështje të sigurisë publike;
- d. kur ekziston vetëm një burim i cili është në gjendje të kryej shërbimin e kërkuar, siç është në rastet kur kryerja e shërbimit kërkon shfrytëzimin e pronësisë intelektuale, të sekreteve afariste ose të drejtave tjera ekskluzive që janë në pronësi të një personi ose grupi të personave të veçantë;
- e. në rastet e propozimeve të pa kërkuara sipas nenit 23;
- f. kur është dërguar një ftesë për pjesëmarrje në procedurë para-seleksionimi ose kur është dërguar një kërkesë për propozime mirëpo asnjë kërkesë ose propozim nuk është dorëzuar ose të gjitha propozimet nuk i kanë përmbushur kriteret e vlerësimit të përcaktuara në kërkesën për propozime dhe nëse, sipas vlerësimit të Autoritetit Kontraktues, dërgimi i një ftese të re për pjesëmarrje në procedurë para-seleksionimi si dhe një kërkesë e re për propozime sipas të gjitha gjasave nuk do të rezultonte në dhënien e projektit brenda afatit kohor të duhur; ose
- g. në të gjitha rastet tjera kur Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik jep pëlqimin për një përjashtim të tillë për arsye të nevojshme në interes publik.

Neni 19
Procedura e negociatave për lidhjen e kontratës së koncesionit

Në rast të një kontrate koncesioni të paraparë në nenin 18, Autoriteti Kontraktues:

- a. shpall publikisht se do të fillojë negociata lidhur me një kontratë koncesioni; kjo nuk vlen për kontratat e koncesionit të negociuara sipas nenit 18, nën paragrafin (c);
- b. hyn në negociata me aq persona sa Autoriteti Kontraktues mendon se nevojiten për zbatimin e projektit brenda rrethanave;
- c. cakton kriteret e vlerësimit në bazë të të cilave propozimet do të vlerësohen dhe do t'u caktohet rang.

4. Propozimet e pa kërkuara

Neni 20
Pranueshmëria e propozimeve të pa kërkuara

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të merr në konsideratë propozime të pa kërkuara sipas neneve 21 deri 23, me kusht që një propozim i tillë nuk ka lidhje me një projekt për të cilin ka filluar ose është paralajmëruar procedura e seleksionimit.

Neni 21
Procedura për pranimin e një propozimi të pa kërkuar

21.1. Pas marrjes dhe shqyrtimit paraprak të një propozimi të pa kërkuar, Autoriteti Kontraktues njofton menjëherë propozuesin se a ka gjasa që propozimi të konsiderohet të jetë në interes publik.

21.2. Nëse projekti konsiderohet se ka gjasë të jetë në interes publik, atëherë Autoriteti Kontraktues fton propozuesin që të dorëzojë për aq sa është e mundur në këtë fazë sa më shumë informata mbi projektin me qëllim që t'i mundësojë Autoritetit Kontraktues ta bëjë një vlerësim të duhur të kualifikimeve të propozuesit si dhe të zbatueshmërisë teknike dhe ekonomike të projektit dhe të përcaktojë se sa ka gjasa që projekti të implementohet në mënyrën e propozuar dhe të pranuar nga Autoriteti Kontraktues. Për këtë qëllim propozuesi ka për detyrë të dorëzojë një studim mbi zbatueshmërinë teknike dhe ekonomike, një studim mbi ndikimin e projektit në mjedis dhe informata të mjaftueshme lidhur me konceptin ose teknologjinë e paraparë në propozim.

21.3. Gjatë marrjes në konsideratë të një propozimi të pa kërkuar, Autoriteti Kontraktues ka për detyrë të respektojë pronësinë intelektuale, sekretet afariste dhe të drejtat tjera ekskluzive që janë pjesë e propozimit ose të cilave u referohet në propozim. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejtë të shfrytëzojë informatat e dhëna nga propozuesi ose në emër të tij në kuadër të propozimit të tij të pa kërkuar përveçse për vlerësimin e këtij propozimi ose nëse propozuesi ka dhënë pëlqimin e vet. Nëse propozimi refuzohet, Autoriteti Kontraktues ia kthen propozuesit origjinalin dhe çdo kopje të dokumentacionit që propozuesi ka dorëzuar dhe që ka përgatitur gjatë procedurës, përveç nëse palët janë marrë vesh ndryshe.

Neni 22

Propozime të pa kërkuara që nuk kanë të bëjnë me pronësi intelektuale, sekrete afariste ose të drejta tjera ekskluzive

22.1. Autoriteti Kontraktues kur vendos të implementojë projektin fillon procedurën e seleksionimit në pajtim me nenet 5 deri 17 nëse konsideron që:

- a. rezultati i paraparë i projektit mund të arrihet pa shfrytëzimin e pronësisë intelektuale, sekreteve afariste ose të drejtave tjera ekskluzive të propozuesit; dhe
- b. koncepti i propozuar teknik nuk është plotësisht unik ose i ri.

22.2. Propozuesi ftohet të merr pjesë në procedurën e seleksionimit të filluar nga Autoriteti Kontraktues sipas paragrafit 1 dhe t'i jepet një lehtësim ose një beneficion i ngjashëm në mënyrën e paraparë në kërkesën për propozime si shpërblim për zhvillimin dhe paraqitjen e projektit.

Neni 23

Propozime të pa kërkuara që kanë të bëjnë me pronësi intelektuale, sekrete afariste ose të drejta tjera ekskluzive

23.1. Në rast të një propozimi të pa kërkuar që ka të bëjë me pronësi intelektuale, sekrete afariste ose të drejta tjera ekskluzive, Autoriteti Kontraktues nuk ka për detyrë të zhvillojë një procedurë seleksionimi sipas neneve 5 deri 17. Autoriteti Kontraktues prapë mund të kërkojë të merr elemente krahasimi për propozimin e pa kërkuar në pajtim me paragrafët 2 deri 4 të këtij neni.

23.2. Kur Autoriteti Kontraktues ka ndërmend të merr elemente krahasimi për propozimin e pa kërkuar, Autoriteti Kontraktues shpall publikisht një përshkrim të elementeve të rezultatit të propozimit së bashku me një ftesë për palë të tjera të interesuara që të dorëzojnë propozime brenda 30 ditëve.

23.3. Nëse nuk merren propozime si përgjigje ndaj ftesës së paraparë në paragrafin 2 të këtij neni brenda afatit të paraparë, atëherë Autoriteti Kontraktues mund të hyjë në negociata me propozuesin e parë.

23.4. Nëse Autoriteti Kontraktues merr propozime si përgjigje ndaj një ftese të paraparë në paragrafin 2, atëherë Autoriteti Kontraktues fton propozuesit në negociata në pajtim me dispozitat e nenit 19. Nëse Autoriteti Kontraktues merr një numër mjaft të madh të propozimeve, të cilët në shikim të parë duken se i plotësojnë nevojat e infrastrukturës, atëherë Autoriteti Kontraktues kërkon dorëzimin e propozimeve sipas neneve 9 deri 17 përfshirë aty edhe një lehtësim ose beneficion tjetër që mund t'i jepet personit që e ka dorëzuar propozimin e pa kërkuar në pajtim me nenin 22, paragrafin 2.

5. Dispozita të ndryshme

Neni 24

Sekreti

Autoriteti Kontraktues trajton propozimet në atë mënyrë që përjashton mundësinë e zbulimit të përmbajtjes së tyre ofertuesve konkurrentë. Çdo diskutim, komunikim ose bisedë mes Autoritetit Kontraktues dhe një ofertuesi sipas nenit 9, paragrafit 3, dhe neneve 17, 18, 19 ose 23, paragrafi 3 dhe 4, duhet të mbetet sekrete. Përveç nëse kërkohet

me ligj ose me urdhër të një gjykate ose nëse lejohet në bazë të kërkesës për propozime, asnjëra nga palët negociuese nuk ka të drejtë t'i zbulojë personave tjerë ndonjë informatë në lidhje me teknologjinë, çmimin ose ndonjë informatë tjetër lidhur me diskutimet, komunikimet ose negociatat e parapara në nenet e mësipërme, përveç nëse pala tjetër ka dhënë pëlqimin e vet për këtë.

Neni 25

Shpallja publike e dhënies së kontratës

Me përjashtim të kontratave të koncesionit të dhëna sipas nenit 18 (c), Autoriteti Kontraktues shpall publikisht dhënien e kontratës në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit për prokurimin publik. Shpallja duhet ta identifikojë koncesionarin dhe ta jep një përmbledhje të elementeve kryesore të kontratës së koncesionit.

Neni 26

Dokumentimi i procedurës së seleksionimit dhe të dhënies së kontratës

Autoriteti Kontraktues ka për detyrë të mbajë të dokumentuara informatat që kanë të bëjnë me procedurat e seleksionimit dhe të dhënies së kontratës në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit për prokurimin publik.

Neni 27

Procedura e rishqyrtimit

Ofertuesi i cili konsideron se ka pësuar ose mund të pësojë një dëm ose një cenim të një të drejte si pasojë e një mos përmbushjeje të një detyrimi që ka Autoriteti Kontraktues në bazë të ligjit mund të kërkojë rishqyrtimin e veprimit ose të mosveprimit të Autoritetit Kontraktues në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit për prokurimin publik.

III. PËRMBAJTJA DHE ZBATIMI I KONTRATËS SË KONCESIONIT

Neni 28

Përmbajtja dhe zbatimi i kontratës së koncesionit

Kontrata e koncesionit përmban së paku këto elemente:

- a. natyrën dhe vëllimin e punëve dhe shërbimeve që duhet të kryhen nga koncesionari;
- b. kushtet për kryerjen e këtyre shërbimeve dhe vëllimin e ekskluzivitetit të të drejtave të koncesionarit sipas kontratës së koncesionit, nëse parashihet një gjë e tillë;
- c. ndihmesën që Autoriteti Kontraktues mund t'ia jep koncesionarit për marrjen e licencave dhe lejeve nëse këto janë të nevojshme për zbatimin e projektit;
- d. çdo kërkesë që ka të bëjë me themelimin dhe kapitalin bazë të një personi juridik të inkorporuar sipas nenit 30;
- e. pronësinë mbi mjetet që kanë të bëjnë me projektin dhe detyrimet e palëve, sipas nevojës, lidhur me përvetësimin e vendit ku do të zbatohet projekti dhe të servituteve të nevojshme në pajtim me nenet 31 deri 33;

- f. shpërblimin e koncesionarit, qoftë në formë të tarifave ose të taksave për shfrytëzimin e infrastrukturës ose kryerjen e shërbimeve; metodën dhe formulat për llogaritjen ose përshtatjen e tarifave ose taksave të tilla; dhe pagesat - nëse ka të tilla - që mund të kryhen nga Autoriteti Kontraktues ose ndonjë autoritet tjetër publik;
- g. procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e dizajneve inxhinjerike, planeve të ndërtimit dhe specifikacioneve të Autoritetit Kontraktues, si dhe procedurat për testimin dhe inspektimin përfundimtar, miratimin dhe pranimin e infrastrukturës;
- h. vëllimin e detyrimit të koncesionarit për të siguruar - sipas nevojës - modifikimin e shërbimit me qëllim të përmbushjes së kërkesës aktuale për shërbimin, vazhdimësinë dhe ofrimin e shërbimit nën kushte kryesisht të barabarta për të gjithë shfrytëzuesit;
- i. të drejtën e Autoritetit Kontraktues ose të ndonjë autoriteti tjetër publik për të mbikëqyrë kryerjen e punëve dhe shërbimeve nga ana e koncesionarit si dhe vëllimin dhe kushtet nën të cilat Autoriteti Kontraktues ose ndonjë autoritet tjetër publik i autorizuar mund të urdhërojë ndryshime që i përkasin punës dhe kryerjes së shërbimit ose të ndërmerr masa tjera të përshtatshme për të siguruar që një infrastrukturë mbahet në veprim në mënyrë të duhur dhe që shërbimet kryhen në pajtim me ligjin dhe me dispozitat e kontratës;
- j. vëllimin e detyrimit të koncesionarit që t'i raportojë dhe ta informojë Autoritetin Kontraktues ose ndonjë autoritet tjetër publik mbi veprimet e veta;
- k. mekanizmat që merren me shpenzimet shtesë dhe pasojat tjera që mund të rezultojnë nga një urdhër i Autoritetit Kontraktues ose të ndonjë autoriteti tjetër publik lidhur me nënparagrafet (h) dhe (i) të këtij neni, përfshirë aty çdo lloj kompensimi që mund t'i takojë koncesionarit;
- l. për aq sa konsiderohet e nevojshme, të drejtat e Autoritetit Kontraktues që të shqyrtojnë dhe miratojnë kontrata të rëndësishme të cilat do të lidhë koncesionari, në veçanti ato me aksionarët e koncesionarit ose persona të tjerë të ndërlidhur;
- m. garancionet e përmbushjes dhe poliset e sigurimit që do të sigurohen nga koncesionari lidhur me implementimin e projektit;
- n. të drejtat dhe detyrimet e palëve nëse ndonjëra palë nuk e përmbushë kontratën;
- o. kushtet nën të cilat ndonjëra palë mund të lirohet nga përgjegjësia për mos përmbushje ose vonesë në përmbushjen e një detyrimi që rrjedh nga kontrata e koncesionit për shkaqe që janë jashtë kontrollit të palës;
- p. kohëzgjatjen e kontratës së koncesionit si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve pas kalimit të kohëzgjatjes ose të shkëputjes së kontratës;
- q. mënyrën e llogaritjes së kompensimit sipas nenit 47;
- r. të drejtën kompetente dhe mekanizmat për zgjidhjen e konflikteve që mund të krijohen mes Autoritetit Kontraktues dhe koncesionarit;
- s. të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me informatat sekrete.

Neni 29
E drejta kompetente

E drejta kompetente për kontratën e koncesionit është e drejta e Kosovës përveç nëse nuk është paraparë ndryshe në atë kontratë.

Neni 30
Organizimi i koncesionarit

Ofertuesi i suksesshëm ka për detyrë të themelojë një formë të veçantë të një shoqërie tregtare, nëse kjo është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në dokumentacionin e para-seleksionimit ose, sipas nevojës, në kërkesën për propozime. Çdo kërkesë lidhur me kapitalin minimal të një personi juridik të tillë dhe të procedurës për marrjen e miratimit nga ana e Autoritetit Kontraktues për statutin dhe rregulloret e punës së tij si dhe për ndryshimet thelbësore të tyre duhet të përcaktohen në kontratën e koncesionit në pajtim me kushtet e parapara në kërkesën për propozime.

Neni 31
Pronësia mbi mjetet

Kontrata e koncesionit specifikon se cilat mjete janë ose do të bëhen pronësi publike dhe cilat mjete janë ose do të bëhen pronësi private e koncesionarit. Kontrata e koncesionit identifikon veçanërisht se cilat mjete hyjnë në kategoritë vijuese:

- a. mjete që koncesionari ka për detyrë t'ia kthejë ose bartë Autoritetit Kontraktues ose ndonjë entiteti tjetër të caktuar nga Autoriteti Kontraktues në pajtim me kushtet e kontratës së koncesionit;
- b. mjete që Autoriteti Kontraktues si opcion mund t'i blejë nga koncesionari; dhe
- c. mjete që koncesionari mund t'i mbajë dhe të disponojë mbi ato pas kalimit të kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit ose shkëputjes së saj.

Neni 32
Fitimi i të drejtave që kanë të bëjnë me vendndodhjen e projektit

Autoriteti Kontraktues ose ndonjë autoritet tjetër publik në bazë të dispozitave të ligjit dhe të kontratës së koncesionit i jep koncesionarit në dispozicion ose, sipas rrethanave, i ndihmon koncesionarit në fitimin e të drejtave që kanë të bëjnë me vendndodhjen e projektit, përfshirë të drejtën e pronësisë, sipas nevojave të projektit.

Neni 33
Servitutet

33.1. Koncesionari ka të drejtë të shkelë mbi pronën e ndonjë pale të tretë, të kalojë përmes saj, dhe të kryej punë ose të vendosë instalime mbi të nëse kjo është e nevojshme për implementimin e projektit në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit për të drejtat sendore.

33.2. Çdo servitut, që nevojitet për implementimin e projektit, krijohet në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit për të drejtat sendore.

Neni 34 Rregullimi financiar

34.1. Koncesionari ka të drejtë të caktojë dhe të vjelë tarifa ose taksa për përdorimin e infrastrukturës ose për shërbimet e tij në pajtim me kontratën e koncesionit, e cila përcakton metodën dhe formulat për llogaritjen dhe përshtatjen e këtyre tarifave ose taksave në pajtim me rregullat e përcaktuara nga organi kompetent publik.

34.2. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të merret vesh me koncesionarin që t'i bëjë pagesa të drejtpërdrejta koncesionarit si zëvendësim ose si shtesë të tarifave ose taksave për shfrytëzimin e infrastrukturës ose të shërbimit të tij.

Neni 35 Mjetet siguroese mbi të drejtat dhe mjetet e koncesionarit

35.1. Varësisht prej ndonjë kufizimi që mund të parashihet në kontratën e koncesionit, koncesionari ka të drejtë të përdorë si mjete siguroese të gjitha mjetet dhe të drejtat e tij, përfshirë ato që kanë të bëjnë me projektin, nëse kjo nevojitet për të siguruar financimin e projektit.

35.2. Aksionarët e koncesionarit kanë të drejtë të përdorin aksionet e tyre si mjete siguroese.

35.3. Asnjë mjet siguroes sipas paragrafit 1 nuk mund të krijohet mbi pronën publike ose mbi prona, mjete dhe të drejta tjera që nevojiten për kryerjen e një shërbimi publik, nëse krijimi i një mjeti të tillë siguroes është i ndaluar me ligj.

Neni 36 Bartja e kontratës së koncesionit

Të drejtat dhe detyrimet e koncesionarit sipas kontratës së koncesionit nuk mund t'i bartën palëve të treta pa pëlqimin e Autoritetit Kontraktues, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe në nenin 35, Kontrata e koncesionit përcakton kushtet kur Autoriteti Kontraktues ka për detyrë ta jep pëlqimin për një bartje të të drejtave dhe detyrimeve të koncesionarit sipas kontratës së koncesionit, përfshirë aty pranimin nga ana e koncesionarit të ri të të gjitha detyrimeve nga kontrata e koncesionit dhe dhënien e dëshmisë nga koncesionari i ri lidhur me aftësitë e tij teknike dhe financiare që nevojiten për kryerjen e shërbimit.

Neni 37 Bartja e të drejtës së kontrollit të koncesionarit

E drejta e kontrollit të koncesionarit nuk mund t'i bartet ndonjë pale të tretë pa pëlqimin e Autoritetit Kontraktues, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe në kontratën e koncesionit,. Kontrata e koncesionit përcakton kushtet kur Autoriteti Kontraktues duhet ta jep pëlqimin e vet.

Neni 38
Mbajtja në funksion të infrastrukturës

38.1. Kontrata e koncesionit përcakton vëllimin e detyrimeve të koncesionarit për të siguruar:

- a. modifikimin e shërbimit me qëllim të plotësimit të nevojave për këtë shërbim;
- b. vazhdimësinë e shërbimit;
- c. ofrimin e shërbimit nën kushte kryesisht të barabarta për të gjithë shfrytëzuesit;
- d. qasje jo-diskriminuuese të ofruesve tjerë të shërbimeve në rrjetin e infrastrukturës publike të drejtuar nga koncesionari.

38.2. Me pëlqim të Autoritetit Kontraktues ose të një autoriteti tjetër publik të autorizuar, koncesionari ka të drejtë të nxjerrë dhe të zbatojë rregulla lidhur me shfrytëzimin e infrastrukturës.

Neni 39
Kompensim për ndryshimin e legjislacionit

Kontrata e koncesionit parasheh se në cilat raste koncesionarit i takon kompensim, nëse shpenzimet e koncesionarit për përmbushjen e kontratës së koncesionit janë rritur dukshëm ose nëse vlera e shpërblimit të cilin koncesionari e merr për përmbushjen e kontratës bjen dukshëm si pasojë e ndryshimit të legjislacionit ose të rregullave që vlejné veçanërisht për infrastrukturën përkatëse ose shërbimin të cilin e kryen.

Neni 40
Revidimi i kontratës së koncesionit

40.1. Pa cenuar nenin 39, kontrata e koncesionit përcakton se në cilat raste koncesionari ka të drejtë të kërkojë revidimin e kontratës së koncesionit me qëllim të përshtatjes së kompensimit, nëse shpenzimet e koncesionarit për përmbushjen e kontratës së koncesionit janë rritur dukshëm ose nëse vlera e shpërblimit të cilin koncesionari e merr për përmbushjen e kontratës bjen dukshëm si pasojë e:

- a. ndryshimit të kushteve ekonomike ose financiare; ose
- b. ndryshimit të legjislacionit ose të rregullave të cilat nuk vlejné veçanërisht për infrastrukturën përkatëse ose shërbimin të cilin e kryen;

me kusht që ndryshimet ekonomike, financiare ose ligjore:

- a. ndodhin pas lidhjes së kontratës;
- b. janë jashtë kontrollit të koncesionarit; dhe
- c. janë të natyrës së tillë që nuk mund të pritët që koncesionari t'i ketë marrë parasysh në kohën kur kontrata e koncesionit është negociuar.

40.2. Kontrata e koncesionit përcakton procedurën për revidimin e kontratës së koncesionit.

Neni 41
Marrja përsipër e projektit nga Autoriteti Kontraktues

Nën kushtet e parapara në kontratën e koncesionit, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që përkohësisht ta merr përsipër drejtimin e infrastrukturës për të siguruar kryerjen e pandërprerë dhe efektive të shërbimit, nëse koncesionari nuk i përmbushë detyrimet kryesore që ka në kuadër të kontratës së koncesionit dhe nuk vazhdon me përmbushjen e

detyrimeve brenda një afati të arsyeshëm pasi që të ketë marrë vërejtjen nga Autoriteti Kontraktues për ta bërë këtë.

Neni 42

Zëvendësimi i koncesionarit

Autoriteti Kontraktues mund të merret vesh me entitetet që financojnë projektin dhe me koncesionarin, që koncesionari të zëvendësohet me një entitet ose person tjetër që do të përmbushë kontratën ekzistuese të koncesionit në rast se koncesionari nuk i përmbushë detyrimet kryesore që ka në kuadër të kontratës së koncesionit ose në raste tjera që do të arsyetonin shkëputjen e kontratës së koncesionit.

IV. KOHËZGJATJA, VAZHDIMI DHE SHKËPUTJA E KONTRATËS SË KONCESIONIT

1. Kohëzgjatja dhe vazhdimi i kontratës së koncesionit

Neni 43

Kohëzgjatja dhe vazhdimi i kontratës së koncesionit

43.1. Kohëzgjatja e koncesionit përcaktohet në kontratën e koncesionit duke marrë parasysh kohëzgjatjen maksimale të lejuar në ligjin përkatës.

43.2. Autoriteti Kontraktues mund ta jep pëlqimin për vazhdimin e kohëzgjatjes së kontratës koncesionit për një periudhë kohore prej jo më shumë se 10 vjet, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe me ligj të veçantë.

43.3. Autoriteti Kontraktues ka për detyrë ta jep pëlqimin për vazhdimin e kontratës së koncesionit kur:

- a. ka vonesë në kryerjen e punës ose ndërprerje të punës për arsye të fuqisë madhore;
- b. projekti suspendohet nga Autoriteti Kontraktues ose ndonjë autoritet tjetër publik; ose
- c. ka një rritje të shpenzimeve si pasojë të kërkesave të Autoritetit Kontraktues të cilat nuk kanë qenë të parapara fillimisht në kontratën e koncesionit, nëse koncesionari nuk është në gjendje të mbulojë këto shpenzime pa një vazhdim të kontratës së koncesionit.

2. Shkëputja e kontratës së koncesionit

Neni 44

Shkëputja e kontratës së koncesionit nga Autoriteti Kontraktues

Autoriteti Kontraktues mund ta shkëputë kontratën e koncesionit:

- a. nëse nuk mund të pritet me arsye që koncesionari do të jetë në gjendje ose i gatshëm të përmbushë detyrimet e veta; ose
- b. për arsye madhore në interes publik, me kusht që koncesionarit t'i paguhet kompensimi i paraparë në kontratën e koncesionit.

Neni 45

Shkëputja e kontratës së koncesionit nga koncesionari

Koncesionari mund ta shkëputë kontratën e koncesionit vetëm në rastet vijuese:

- a. në rast se Autoriteti Kontraktues ose ndonjë autoritet tjetër publik nuk përmbushë një detyrim thelbësor lidhur me kontratën e koncesionit;
- b. nëse janë plotësuar kushtet për një revidim të kontratës së koncesionit sipas nenit 40, paragrafit 1, mirëpo palët nuk janë pajtuar për revidimin e kontratës së koncesionit; ose
- c. nëse shpenzimet e koncesionarit për përmbushjen e kontratës së koncesionit janë ngritur dukshëm ose nëse vlera e shpërblimit që koncesionari merr për përmbushjen e kontratës bjen dukshëm si rezultat i një veprimi ose mosveprimi të Autoritetit Kontraktues, dhe palët nuk janë pajtuar për një revidim të kontratës së koncesionit.

Neni 46

Shkëputja e kontratës së koncesionit në rastet tjera

Secila palë ka të drejtë ta shkëputë kontratën e koncesionit nëse përmbushja e detyrimit të saj bëhet e pamundur për arsye të fuqisë madhore. Po ashtu palët mund ta shkëpusin kontratën e koncesionit me marrëveshje.

3. Rregullimi i raporteve pas shkëputjes së kontratës së koncesionit ose kalimit të kohëzgjatjes së saj

Neni 47

Kompensimi pas shkëputjes së kontratës së koncesionit

Kontrata e koncesionit parasheh se si llogaritet kompensimi që i takon palës kontraktuese përkatëse në rast të një shkëputjeje të kontratës së koncesionit, duke përfshirë në llogaritjen e kompensimit - sipas rrethanave - vlerën e punës së kryer sipas kontratës së koncesionit, shpenzimet ose humbjet që ka pësuar ndonjëra palë, përfshirë aty edhe fitimin e humbur.

Neni 48

Masat përfundimtare

Kontrata e koncesionit parasheh sipas nevojës:

- a. procedurën për bartjen e mjeteve tek Autoriteti Kontraktues;
- b. kompenzimin që mund t'i takojë koncesionarit lidhur me bartjen e mjeteve tek Autoriteti Kontraktues ose një koncesionar të ri ose në rast se Autoriteti Kontraktues i blenë mjetet;
- c. transferin e teknologjisë së nevojshme për mbajtjen në funksion të infrastrukturës;
- d. aftësimin profesional të personelit të Autoritetit Kontraktues ose të një koncesionari trashëgues lidhur me mbajtjen në funksion dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës;
- e. kryerjen e vazhdueshme të shërbimeve ndihmëse nga koncesionari, përfshirë aty furnizimin me pajisje rezervë sipas nevojës për një periudhë të arsyeshme pas bartjes së infrastrukturës tek Autoriteti Kontraktues ose një koncesionar trashëgues.

V. ZGJIDHJA E KONTESTEVE

Neni 49

Kontestet mes Autoritetit Kontraktues dhe koncesionarit

Kontestet mes Autoritetit Kontraktues dhe koncesionarit lidhur me përmbushjen dhe interpretimin e kontratës së koncesionit zgjidhen me anë të procedurave për zgjidhjen e kontesteve për të cilat janë pajtuar palët në kontratën e koncesionit.

Neni 50

Konteste që kanë të bëjnë me konsumatorë ose shfrytëzues të infrastrukturës

Kur koncesionari i kryen shërbime publikut ose drejton një infrastrukturë në të cilën ka qasje publiku, atëherë Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë krijimin e procedurave të thjeshta dhe efektive për shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve ose shfrytëzuesve të infrastrukturës.

VI. KOMISIONI RREGULLATIV PËR PROKURIM PUBLIK

Neni 51

Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik

51.1. Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (Komisioni) ka për detyrë të sigurojë zbatimin e këtij ligji. Për këtë qëllim, Komisioni kryen funksionet dhe ushtron kompetencat që ka sipas Ligjit për Prokurimin Publik edhe lidhur me zbatimin e këtij ligji.

51.2. Komisioni ka kompetencën të krijojë dhe të nxjerrë rregulla dhe akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji. Për këtë qëllim, Komisioni kryen funksionet dhe ushtron kompetencat që i ka Komisioni i Rregullave në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik.

VII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 52

Shfuqizimi i legjislacionit të mëparshëm

Ky ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë të këtij ligji kanë epërsi mbi legjislacionin e mëparshëm për dhënien e kontratave të koncesionit në Kosovë.

Neni 53

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-44
3 tetor 2005

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci